

Emocionet e nanës natyrë

(marrë nga gazeta Danas 30 tetor 2008 Beograd)

Pa dyshim Budva është bërë plazhë botnor. Kësaj vere i ngjante kullës biblike të Babilonisë. Në dy banor një ka kene i huaj. Nuk ka ndodhur që një gjuhtar të ndigjojë një bisede dhe të mos dijë se nga cili vend vijnë fjalët që ndigjon, kështu në rrugë, në plazh e në ujë.

Natyrisht nuk është e pazakontë të takosh një shqiptar. Kështu nuk është e rastit takimi me personin për të cilin po ju flas. Është vërtet i jashtëzakonshëm.

Quhet Muhamet Trepci nga Shkodra me të cilin u njoha rastësisht. Me mbeten sytë tek një figure prej drunit të ullinit që i varej në qafe. Mu afrue dhe bame një bisedë. Muhameti është mjeshter i punimit të drunit te ullinit. Një dite duke punuar në një trung të vjetër ullini vuri re që ullini kishte dicka me i tregue.

Zbuloi pamje të çuditshme të configurueme në dru të mshehuna në vite.

Nga ky çast me një kujdes të veçantë ka ndjekur pamjet (figurat) në prerjet e drunit te ullinit. Pak nga pak evidentoi lojën fine të nuancave (të vijave) të drunit të ullinit. Ishin këto figura të njohura diku njëzore ose figura të kafshëve të ndryshme, me tepër të zogjve dhe nganjëherë vizatime abstrakte të tipit Pikaso. Më shpesh është fjala për kalimin nga abstraktja te konkretja dhe anasjelltas.

Para pamjeve të tilla instiktivisht i befasuar të lind një ndjenjë kënaqësie të vërtete pa marrë parasysh origjinën e asaj që ke para syve. Nuk e mbajti të msheften për vete. Ja bëri të njohur artisteve, muzeumeve dhe një ditë gjeti ngrohtësine në mes të eksponenteve të Muzeut Nacional të Romes (Vittoriano). Ka kërkuar midis shkrimeve të estetëve e piktorve më të njohur të kohës si Umberto Eco dhe Picaso ku ka gjetur aprovimin për mendimin e vet e është fjala për gjera artistike.

Njohësit e artit tregojnë se pikturën artistike nuk e bën vetëm dora e njeriut, por e krijon edhe natyra kur mendja e mprehtë njerzore arrin të njohë natyrën nga ana estetike. Këtë e dashuron

dhe është ajo që Muhameti zbulon dhe grumbullon. Vërtet në këtë që ka pak mistere ai me modesti thekson që ai vetëm zbulon dhe kur flitet për autorin me thjeshtësi drejton syte nga qielli.

Na mbetet me dëshirë të biem dakort me të e të mendojmë për lojën e pabesueshme të natyrës me plot të papritura dhe të rastit që vetëm syni i artistit mund ti njohë. Në qoftë se pamje (figura) të cilat Muhameti i huazon nga druni i ullinit u ekspozuan në Romë në Muzeumin Nacional të Shtetit Italian dhe po shqyrtohet për një ekspozim të mundshëm në Louver, atëhere nuk duhet të dyshojmë se Muhameti është në “miqësi” me artin duke e pagezue atë “Me emocionet e Nanës Natyrë”. Për këtë ka shkruar një libër të bukur me të njëjtin titull nga ku ju mund të shihni një nga ilustrimet e shumta. Mbani mend se në qoftë se e takoni mikun tim me figurën e dashur të ullinit rreth qafes së tij, ndaluni e bashkëbisedoni me të dhe të jeni i sigurtë që figura me shpejtësinë e dritës do të kalojë nga qafa e tij tek e jotja. Në qoftë se tregoni më tepër interes për punën e tij do të pajiseni me bylyzyk shumë të bukur për bashkëshorten apo vajzën nga druni i ullinit me konfiguracionet e mrekullshme të këtij druni.

Radosllav Gjerić

“Danas” Beograd 30 tetor 2008